



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:075049

Datë: 29.04.2019

Numri i dokumentit: 00293627

P.nr.137/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Berna Maliqi, në çështjen penale kundër të pandehurit E. B..nga Gj..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.118/2018, të datës 05.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe jo publik me datë 24.04.2019, mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri E... B..., nga babai R... dhe nëna V..., e lindur B..., i lindur me datë..., në fshatin K..., Komuna e K..., me vendbanim në Gj..., rr."...", nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 18.01.2019, rreth orës 16:00 h, në Gjilan, në rr."Metush Krasniqi", në shtëpinë familjare, i pandehuri E... B..., me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor të bashkëjetueses së tij-të dëmtuarës R... R..., ka shkaktuar dhunë në familje në kundërshtim me nenin 2 nënparagrafi 1.2.5 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, duke goditur fizikisht të njejtën, në prani të fëmijës së tyre 1 vjeçar, në atë mënyrë që pas një mospajtimi që kishin lidhur me atë që e dëmtuara të merrte me vete fëmijën e tyre të përbahskët për një vizitë tek familja e saj, për të cilën i pandehuri nuk pajtohet, pason një debat verbal, me prast i njejtë tensionohet tej mase dhe të dëmtuarën e godet me duar fillimisht në fytyrë, më pas me bokse në shpinë ku ndërhyjnë nëna e të pandehurit dhe e ndalon mirëpo kur e dëmtuara i thotë se më nuk do ta shohë djalën, i pandehuri përsëri e godet me shqelma në shpinë që sipasojë e goditjeve të dëmtuarës i shkakton lëndime trupor të cilat evidentohen si në ekspertizën mjekoligjore të datës 29.01.2019.

-Me çka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit E... B..., i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (muajve) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 2 (dy) viteve nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzetepesë euro), në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 06.02.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.118/18, kundër të pandehurit Egzon Beqiri nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i KPRK-së.

Me datë 24.04.2019, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit dhe i pandehuri E... B... ndërsa munguan e dëmtuara dhe përfaqësuesit e ZMNV-ës në Gjilan, të cilët kanë që ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

### 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmbanë aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehuri Egzon Beqiri, ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i KPRK-së, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqyrtimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 2 (dy) viteve nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale ngase eduke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njejtë është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij duke pasur parasysh edhe faktin se është sipas deklaratimit të tij por edhe të dëmtuarës (të dhënë në deklaratën e saj në polici) është hera e parë që të njejtin kanë pasur probleme të natyrës së tillë, po ashtu faktin se të njejtin vazhdojnë të jetojnë së bashku në shtëpinë e të pandehurit dhe se nga dita e kryerjes së kësaj veprë penale të nejtë më nuk kanë pasur asnjëherë probleme të tilla dhe se i njejtë ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, po ashtu gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njejtë bie ndesh ligjin, dhe se me këtë lloj të dënimit mund të arrihet parandalimi i kryesit që në të ardhmen të kryej vepra të tilla ose të tjera penale si dhe rabilitimi i tij ndërsa si rrethanë rënduese gjykata parasysh faktin se se nga veprimet e të pandehurit, të dëmtuarës Rajmonda Rexhepi, i është cënuar integritetit trupor përkatësisht e njejtë ka pësuar lëndime të lehta trupore të përshkruara si në ekspertizën mjekoligjore të datës 29.01.2019 andaj gjykata konsideron dënimin i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

#### 5. Vendimi lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën Rajmonda Rexhepi, nga Gjilani, e udhëzoi në kontest civil.

#### 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.137/2019, me datë 24.04.2019

Procesmbajtësja,  
Berna Maliqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.